

**Interreg**



Co-funded by  
the European Union

**IPA** Greece – Albania

---

**Llogaritë Bankare dhe informacion mbi përdorimin e Fondit për parafinancim,  
bashkëfinancim dhe pagesën e tatimit mbi vlerën e shtuar dhe detyrimeve  
doganore për projektet me financim të huaj.**

**Greqi – Shqipëri 2021-2027**

**Ditë Informuese për Zbatimin e Projekteve të Thirrjes së Parë  
16-17 Shtator 2025**

**Interreg VI-A IPA CBC ‘Greece-Albania 2021-2027’ Programme  
CCI: 2021TC16IPCB010  
C (2022) 8883 final – 29.11.2022**

**Interreg**



Co-funded by  
the European Union

**IPA** Greece – Albania

---

## INFORMACION MBI ÇELJET E LLOGARIVE BANKARE

**Ditë Informuese për Zbatimin e Projekteve të Thirrjes së Parë  
16–17 Shtator 2025**

Interreg VI-A IPA CBC 'Greece-Albania 2021-2027' Programme  
CCI: 2021TC16IPCB010  
C (2022) 8883 final – 29.11.2022



## Udhëzues për Procedurat e Projekteve me Financim të Huaj sipas Skemës me Thesar të Plotë

### ÇELJET E LLOGARIVE BANKARE

- ✓ Llogaritë bankare për të gjitha institucionet shtetërore do të hapen sipas **Udhëzimit të ri nr. 10, datë 12.07.2024 “Për Regjistrimin, Përdorimin, Rakordimin, Raportimin dhe Publikimin e Fondeve të Financimit të Huaj në Kuadër të Marrëveshjeve Ndërkombëtare”**, të nxjerrë nga Ministria e Financave.
- ✓ Udhëzimi parashikon procedura specifike në rastin kur përfituesi/partneri mban rolin **e partnerit lider** dhe kur mban rolin **e partnerit**.

*Të gjithë hapat e përcaktuar në këtë udhëzim duhet të ndiqen saktësisht nga përfituesit.*

### Përfitimet e këtij Udhëzimi:

- ✓ Të gjitha grantet nga donatorët e huaj do të disbursohen në një llogari të vetme **Llogaria e Vetme e Thesarit (TSA) në Bankën e Shqipërisë;**
- ✓ **Ul ndjeshëm kohën për hapjen e një llogarie bankare të nivelit të dytë, p.sh. 2-3 ditë nga dita e disbursimit të fondeve nga donatori në TSA;**



**Udhëzues për Procedurat e Projekteve me Financim të Huaj sipas Skemës me Thesar të Plotë  
ÇELJET E LLOGARIVE BANKARE --- HAPAT**

**Hapi 1: Kërkesa për konfirmimin e TSA-së**

NJZP-ja (Njësia e Zbatimit të Projektit), menjëherë pas:

- a) Nënshkrimit të marrëveshjes së grantit
- b) Marrjen e miratimeve respektive sipas legjislacionit (p.sh. miratim nga Keshilli Bashkiak)

i dërgon kërkesë Ministrisë së Financave për konfirmimin e të dhënave të TSA-së.

*Në kërkesë përfshihen:*

- a. Kodi i institucionit;
- b. Emri i institucionit;
- c. Kodi i produktit buxhetor (kapitulli 02 "Financim i huaj");
- d. Emri i produktit, i hapur paraprakisht në SIFQ.**

**Hapi 2: Verifikimi dhe lëshimi i Formularit të Identifikimit Financiar (FIF)**

Ministria e Financave, pasi merr konfirmimin nga BSH, i dërgon NJZP-së FIF-in e plotësuar.

FIF përmban:

- a. Referencat e TSA-së;
- b. Kodin dhe emërtimin e institucionit;
- c. Kodin e projektit/produktit;
- d. Përshkrimin, sipas kërkesës së NJZP-së.

*Shenim\* Lidhur me afatet kohore për dërgimin e konfirmimit të të dhënave të llogarive speciale "Depozite e Qeverisë" institucionit/ NJZP, zbatohet legjislacioni në fuqi për trajtimin e shkresave zyrtare, ku për rastet normale afati është 7 dite pune.*



**Udhëzues për Procedurat e Projekteve me Financim të Huaj sipas Skemës me Thesar të Plotë**  
**ÇELJET E LLOGARIVE BANKARE --- HAPAT**

**Hapi 3: Njoftimi i Donatorit**

- a. NJZP-ja ia dërgon FIF-in e konfirmuar donatorit.
- b. Donatori, në momentin e disbursimit, duhet të shënojë në përshkrimin e pagesës të dhënat e fushës REMARK të FIF-it.

**Hapi 4: Disbursimi i fondeve**

- a. Grantet disbursohen në TSA në BSH, sipas referencave të konfirmuara.
- b. Transaksioni i disbursimit duhet të përmbajë:
  - a. Kodin dhe emrin e institucionit përfitues;
  - b. Kodin dhe emërtimin e projektit/produktit.

Shenim\* Lidhur me afatet kohore për ekzekutimin e shkresave, për konfirmimin e të dhenave të llogarise speciale zbatohet legjislacioni në fuqi për trajtimin e shkresave zyrtare, ku për rastet normale afati është 7 dite pune.



**Udhëzues për Procedurat e Projekteve me Financim të Huaj sipas Skemës me Thesar të Plotë**  
**ÇELJET E LLOGARIVE BANKARE --- HAPAT**

**Hapi 5: Njoftimi dhe konfirmimi i fondeve**

- a. Pas kreditimit të TSA-së, Thesari në qendër njofton elektronikisht NJZP-në.

*Shenim: \* Njoftimi elektronik i institucionit behet sapo mberrin posta e bankes ne sektorin e TSA.*

- b. NJZP-ja, menjëherë pas njoftimit, konfirmon se fondi i ardhur i përket projektit të saj.

- c. Thesari kryen kontabilizimin e disbursimit në **SIFQ** dhe njofton degën e thesarit respektive.

*Shenim\* Procesimi i ditarit ne sistem behet sapo merret konfirmimi nga institucioni/NJZP.*

**Hapi 6: Alokimi i fondeve për shpenzim**

- a. NJZP-ja paraqet pranë degës së thesarit kërkesën për rritjen e autorizuar të fondit.

- b. Dega e thesarit bën alokimin e të ardhurës në llogaritë e shpenzimeve sipas kërkesës së NJZP-së, duke e bërë menjëherë të vlefshme për shpenzim.



**Udhëzues për Procedurat e Projekteve me Financim të Huaj sipas Skemës me Thesar të Plotë**  
**ÇELJET E LLOGARIVE BANKARE --- HAPAT**

**Hapi 7: Ekzekutimi i shpenzimeve**

- a. Pagesat për projektin kryhen pranë degës së thesarit ku operon NJZP-ja.
- b. Prokurimet bëhen sipas kushteve të përcaktuara në marrëveshjen e grantit.

**Hapi 8: Disbursime me rimbursim**

(kur parashikohet në marrëveshje)

- a. Në rastet kur shpenzimet paguhen fillimisht nga fondet buxhetore vendore dhe më pas rimbursohen nga donatori:
- b. Disbursimi i rimbursuar kontabilizohet në **SIFQ** në një llogari ekonomike të veçantë me emërtimin **“Rimbursim i shpenzimeve pas kryerjes së pagesës”**.



**Udhëzues për Procedurat e Projekteve me Financim të Huaj sipas Skemës me Thesar të Plotë**  
**ÇELJET E LLOGARIVE BANKARE --- HAPAT**

**Hapi 9: Raportimi mujor i NJZP-së**

Brenda datës 5 të çdo muaji, NJZP-ja dërgon elektronikisht tek Thesari në qendër:

- *Të dhënat mbi disbursimet;*
- *Shpenzimet indirekte (nëse grantet menaxhohen drejtpërdrejt nga donatori).*

*\*Shenim Per projektet me thesar te plote nuk kryhet raportim por rakordim me degen e thesarit.*

**Hapi 10: Rakordimi mujor**

- a. Brenda datës 5 të çdo muaji, NJZP-ja rakordon me degën e thesarit për të ardhurat dhe shpenzimet progresive të vitit buxhetor.
- b. Gjenerohet raporti nga SIFQ, i cili nënshkruhet nga të dyja palët (NJZP dhe Thesari).



**Udhëzues për Procedurat e Projekteve me Financim të Huaj sipas Skemës me Thesar të Plotë  
ÇELJET E LLOGARIVE BANKARE --- HAPAT**

**Hapi 11: Trashëgimi i fondeve të papërdorura**

Në fund të vitit buxhetor, NJZP-ja, mbi bazën e akt-rakordimit me thesarin, **kërkon trashëgimin e fondeve të papërdorura në vitin pasardhës.**

*Ne rastet kur perfituesi është Partner Lider, Udhezimi percakton disa hapa te tjera shtese.*

**Interreg**



Co-funded by  
the European Union

**IPA** Greece – Albania

---

## PARAFINANCIMI, BASHKEFINANCIMI DHE TVSH

Info Day Implementation 1<sup>st</sup> Call Projects  
16-17 September 2025

Interreg VI-A IPA CBC 'Greece-Albania 2021-2027' Programme  
CCI: 2021TC16IPCB010  
C (2022) 8883 final – 29.11.2022



## PARAFINANCIMI, BASHKËFINANCIMI DHE RIMBURSIMI I TVSH-SË

- **Parafinancimi, bashkëfinancimi dhe rimbursimi i TVSH-së** bazohet në Ligjin Nr. 115/2024 “Për Buxhetin 2025” dhe Udhëzimin plotësues nr. 2, datë 24.01.2025 “Për Zbatimin e Buxhetit 2025”.
- Një shumë e dedikuar prej **100 milionë Lekësh (ALL)** alokohet çdo vit për të mbështetur si institucionet publike qendrore ashtu edhe ato vendore në përmbushjen e detyrimeve të tyre që lidhen me parafinancimin, bashkëfinancimin dhe rimbursimin e TVSH-së për projektet e financuara nga BE-ja dhe donatorët.
- Kërkesat për mbështetje financiare janë ulur me kalimin e kohës, duke reflektuar **rritjen e kapaciteteve institucionale** dhe **ndërgjegjësimin në rritje** të njësive publike mbi rëndësinë e planifikimit paraprak në buxhet të shumave për të mbuluar detyrimet e bashkëfinancimit të projekteve të BE-së.
- Hapat që duhet të ndjekin përfituesit shqiptarë për të kërkuar fondin janë të specifikuara në **Aneksin B** të Udhëzimit “Për Përdorimin e Fondit për Parafinancimin, Bashkëfinancimin dhe Pagesën e Tatimit mbi Vlerën e Shtuar dhe Detyrimeve Doganore për Projektet me Financim të Huaj, miratuar me Ligjin nr. 115 datë 03.12.2024 “Për Buxhetin 2025”, faqet 59-60 të Udhëzimit.
- Kërkesa e bërë nga përfituesit duhet të jetë **e argumentuar mirë** për arsyen pse përfituesi nuk ka mundësi të mbulojë vetë shumat e parafinancimit dhe bashkëfinancimit.